



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE
PER KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2024

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
1.	03.01.2024	Kerkese per informacion KLGJ-shkrese përcjellëse per informacion me kërkues Armand Kullua mbi numrin e çështjeve te shortuara manualisht per periudhën 2018 deri ne dhjetor 2023	10.01.2024	Ish Gjykata e Shkalles se pare per krime te Renda, per vitin kalendarik 2018, 2019 nuk ka shortuar asnjë çështje me short manual. GJKKO, per vitin kalendarik 2020 ka hedhur short manual vetëm ne 3 data, per shkak te mungesës se specialistit te IT dhe personelit te gjykatës, si pasoje e periudhës se COVID-19.	Perfunduar	Nuk ka
2.	15.01.2024	Kërkesë për bashkëpunim në lidhje me zbatimin e projektit të financuar nga BE: "Ndërtimi i partneritetit në Kryesoret, fuqizimi i	24.01.2024	GjKKO duke falënderuar dhe uruar suksese, cakton nje date takimi.	Perfunduar	Nuk ka

		shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE” QENDRA PER TRANSPARENCE DHE INFORMIM TE LIRE Sami Nezaj qTIL, drejtor ekzekutiv				
3.	14.02.2024	Vendime penale ndaj shtetasit Altin Çoku Klodiana Lala, gazetares News 24	19.02.2024	2 Vendime penale ndaj shtetasit Altin Coku	Perfunduar	Nuk ka
4.	16.02.2024	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, kopje vendimesh të marra nga GJKKO Gazetari Birn			Perfunduar Kryesekretaria	Nuk ka
5.	26.02.2024	Gazetari Elton Qyno, kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentet zyrtare, lidhur me një vendim të ndërmjetëm të marrë nga Gjyqtari i Krimeve të Rënda, Guri Brahimllari, në vitin 2008 ose 2007 në çështjen për gjykim kundër Lulzim Berisha e	29.02.2024	Në vijim të shqyrtimit të kërkesës tuaj ku kërkon vendimin e ndërmjetëm lidhur me ndalimin e publikimit të dëshmisë së bashkëpunëtorit të drejtësisë Adriatik Coli, të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ju bëjmë me dije se kjo dosje nuk ndodhet në arkivën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin	Perfunduar	Nuk ka

		të tjerë personave.		e Organizuar. Kjo për faktin, pasi me shkresën Nr. 171 Prot., datë 27.12.2021 të kësaj Gjykate të gjitha dosjet që lidhen me çështjen e mësipërme janë përcjellë për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Ndodhur në këto kushte, jeni i lutur t'i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për të marrë informacionin që kërkon. Bashkëlidhur, gjeni shkresën zyrtare Nr. 171 Prot, datë 27.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.		
6.	06.03.2024	Unë Besmir Pula, gazetar i MCN TV, te dhëna/statistika ne lidhje me: 1. Sa pasuri të paluajtshme janë sekuestruar nga SPAK gjatë vitit 2023 dhe sa është vlera totale e	06.03.2024	Kerkesa u regjistrua dhe bashkëlidhur Analiza vjetore 2023 e GJKKO me te gjitha te dhënat e kërkuara.	Perfunduar	Nuk ka

		tyre? 2. Sa automjete janë sekuestruar nga SPAK dhe sa është vlera e tyre ne total? 3. Kryesisht nga çfarë aktiviteti të paligshëm janë përfituar këto pasuri, dhe pas sekuestrimit përfundimtar ku dorëzohen këtë pasuri?				
6.	07.03.2024	Qendra per Studimin e Demokracise dhe Qeverisjes (CSDG) Arjan Dymishi, Drejtor Ekzekutiv Kerkese per Dokumentacion te vendimeve per çështje te korrupsionit dhe krimit te organizuar per vitin 2022 dhe 2023 Kopje te Vendimeve te GJKKO-se per 2022 Kopje te vendimeve te GJKKO-se per 2023			Korrespondence midis Qendres dhe Titullarit, kryesekretarise ne dhënien e përgjigjes se kerkuar	Nuk ka
7.	08.03.2024	Qeleshi and Associate Studio Ligjore Kerkese per Informacion ne lidhje me statistika	21.03.2024	Ne adresën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 08. 03.2024, ka mbërritur 'Shkresa", e dërguar	Perfunduar	Nuk Ka

				prej jush, ku kërkoni të dhëna në lidhje me vendimet e marra nga GJKKO (numrin e kërkesave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Pas verifikimeve të kryera në Kryesekretarinë e GJKKO-së, rezulton se janë gjithsej 15 vendime të marra nga GJKKO, në lidhje me pranimin apo rrëzimin e kërkesave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në 14 vendime, kërkesat e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme janë pranuar, ndërsa vetëm 1 vendim është rrëzuar kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme.		
8.	11.03.2024	Muhamed Veliu, gazetar i Top Channel Kerkese per vënie ne dispozicion te Vendimit Nr. 330, date 23.09.2020.	12.03.2024	Vendimi Nr. 330, eshte me Ekzekutim letër Porosi dhe rrjedhimisht refuzohet kërkesa per marrjen e vendimit, pasi eshte çështje nen hetim dhe ka sekrete hetimore.	Perfunduar	Nuk Ka
9.	27.03.2024	Anila Hoxha Gazetare e Top Channel	16.04.2024	Kërkesë per vendimin e zbardhur ndaj shtetasit Safet Gjici etj	Përfunduar zyrtarisht vendimi i	Nuk ka

				2) Vendimet për pastrim parash nga viti 2022-2023-2024 përfshi dhe ato të miratuara nga gjykata mbasi SPAK e ka pushuar/ mosfilluar procedimin?	skanuar, marrë me usb.	
10.	16.04.2024	Armand Bajrami Gazetar A2CNN	16.04.2024	Kërkesë për kopje të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë të çështjes me të pandehur Dhionisis Alfred Beleri dhe Pandeli Kolaveshi.	Përfunduar zyrtarisht vendimi i skanuar, marrë me usb.	Nuk ka
11.	08.04.2024	Top News Gazetare Alketa Shaba	23.04.2024	Statistika të vitit 2023 sa i përket masave të sigurisë që ka kërkuar SPAK ndaj personave nën hetim dhe masat që ka vendosur GJKKO ndaj këtyre personave. Konkretisht, kërkoj të më vihet në dispozicion numri i masave të sigurisë “arrest në burg”, “arrest në shtëpi” dhe “detyrim paraqitje” të cilat SPAK i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme Anti-korrupsion dhe rastet me shifra kur GJKKO ka vendosur një tjetër masë nga ajo që ka kërkuar SPAK.	Perfunduar dhe kthim përgjigje me te gjitha statistikat e kerkuara	Nuk ka
12.	23.04.2024	Top Channel Gazetare Anila Hoxha		Referuar ligjit per te drejten e informimit jeni te lutur t me vendosni ne dispozicion vendimin per shtetasin Adedin Rexha denuar nga ish Gjykata Kunder Krimeve te Renda.	Perfunduar dhe kthim përgjigje nga Kryesekretaria	Nuk ka

13.	23.07.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të Vendimit Nr.45, datë 06.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.	23.07.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 13, datë 23.07.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është dhënë vendimi penal me nr.45, datë 06.06.2019, në ngarkim të të pandehurit F.D, i deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal. Bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin e sipërcituar në rrugë elektronike. Ju sjellim në vëmendje se, në referim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht të: Nenit 2, i cili parashikon se: “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.”; Nenit 3 pika 2, i cili përkufizon se:	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka
-----	------------	---	------------	--	------------------------	--------

				“Të dhëna sensitive është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.”; Nenit 11, i cili parashikon se: “Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike përjashtohet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes”; të ruhet konfidencialiteti i të dhënave të viktimave të veprës penale.		
14.	26.07.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të Vendimit Nr.68, datë 14.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	26.07.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 14, datë 26.07.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është shqyrtuar në seancë gjyqësore, me	Përfunduar; Refuzuar (E-mail)	Nuk ka

				dyer të mbyllura, çështja penale me nr.regj.themeltar 94, datë rregjistrimi 17.05.2022, në ngarkim të të pandehurit B.P, i cili me vendimin nr.68, datë 14.12.2022 të kësaj gjykate është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur” dhe “Organizata terroriste”, parashikuar nga nenet 230/ç dhe 234/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Në seancën gjyqësore të datës 28.09.2022, prokurori ka kërkuar zhvillimin e seancës gjyqësore me dyer të mbyllura për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Po në këtë seancë gjyqësore, gjykata me vendimin të ndërmjetëm, bazuar në nenin 340/1/a të K.Pr.Penale, ka vendosur vijimin e gjykimit me dyer të mbyllura. Në këto kushte, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), i cili parashikon se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e		
--	--	--	--	---	--	--

				veprave penale.”; si dhe nenit 103, pika 1, 2 dhe 3 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “ 1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv; 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake; 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”, duke qenë se mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, përbën vepër penale sipas nenit 295/a të Kodit Penal nën titullin “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, konstatojmë se kërkesa juaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin penal të dhënë në ngarkim të shtetasit B.P nuk mund të pranohet. Sa më sipër, refuzojmë kërkesën tuaj	
--	--	--	--	---	--

				për t'ju vënë në dispozicion vendimin nr.68, datë 14.12.2022, në ngarkim të shtetasit B.P.		
15.	04.09.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me veprat penale “ <i>Trafikimi i personave të rritur</i> ”, “ <i>Trafikimi i të miturve</i> ”, “ <i>Shfrytëzimi i prositucionit</i> ”, parashikuar në nenet 110/a, 114 dhe 128/b të Kodit Penal, kur këto vepra janë kryer nga grupe të strukturuar kriminale, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda të armatosura, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, për periudhën 2021-2023 të ndara sipas viteve, si dhe kërkohet informacion në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë. Kërkesë për informacion lidhur me numrin e procedimeve të rregjistruara në gjykatë për çështjet me objektin e	06.09.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të protokolluar pranë kësaj gjykate me Nr.2992 Prot., datë 05.08.2024, ju bëj me dije si më poshtë: Së pari, kërkesa juaj për informim është rregjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me datë 04.09.2024, me numër rendor 15, për shkak se stafi administrativ i gjykatës ka qenë me leje vjetore sipas parashikimeve të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “ <i>Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë</i> ”, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.732, datë 13.11.2019 “ <i>Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë</i> ”. Së dyti, pas verifikimeve të bëra si në sistemin elektronik të regjistrimit të çështjeve të kësaj Gjykate, po ashtu	Përfunduar; Deleguar pranë SPAK kërkesa për informacion lidhur me numrin e procedimeve të rregjistruara. (E-mail)	Nuk ka

		sipërcituar, të ndarë sipas objektit dhe sipas viteve.	dhe në Kryesekretarinë e Gjykatës, rezulton se për periudhën kohore 2021-2023, nga kjo gjykatë nuk është dhënë asnjë vendim penal në lidhje me veprat penale “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, “<i>Shfrytëzimi i prositucionit</i>”, të parashikuara nga nenet 110/a, 128/b dhe 114 të Kodit Penal, të kryera si vepra penale në kuadër të grupit strukturuar kriminal, organizatës kriminale, apo organizatës terroriste dhe bandës së armatosur, parashikuar nga nenet 333/a, 333, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal. Së treti, sa i përket kërkesës për informacion lidhur me numrin e procedimeve të rregjistruara në gjykatë për çështjet që kanë për objekt veprat penale të sipërcituara, ju informojmë se rregjistrimi i një procedimi penal nuk është kompetencë e gjykatës dhe kjo gjykatë nuk e disponon një informacion të tillë. Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë procedimet penale rregjistrohen nga organi i prokurorisë. Në këto kushte, në referim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr.119/2014, “<i>Për</i>	
--	--	---	--	--

				<i>të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”, kërkesa juaj për informim lidhur me këtë pjesë i ka kaluar ditën e sotme autoritetit publik kompetent, konkretisht Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.</i> Në zbatim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, po ju dërgojmë dhe kontaktin zyrtar elektronik (email-in) të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: Info@spak.gov.al		
16.	06.09.2024	Kërkesë për informacion: 1. A kanë gjykatat e të gjitha niveleve një zë në buxhet për të paguar përkthyesit e gjuhës së	12.09.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, përcjellë për kompetencë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën Nr.4160/2 Prot., datë 03.09.2024, protokolluar	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave dhe sa ka qenë ky zë për secilin nga 5 vitet e fundit? 2. Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit? 3. Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhës së shenjave, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit? 4. Sa procese penale me të pandehur me persona me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur ka pasur në gjykatat e të gjitha niveleve në 5 vitet e fundit, për secilin vit? 5. Me çfarë procedure dhe nga kush realizohet përzgjedhja dhe kontaktimi i përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe të gjuhës së shenjave, për një proces penal?		në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Nr.3134 Prot., datë 06.09.2024 dhe regjistruar me numër rendor 16, datë 06.09.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju dërgojmë përgjigjet e pyetjeve si më poshtë vijon: 1. Po, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjatë detajimit të buxhetit në fillim të vitit, planifikon një zë të veçantë për shpenzime për përkthyesit zyrtarë të gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave. Sipas pasqyrës së fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara në zërin “Shpenzime përkthimi”, për vitin 2024 ky zë është planifikuar në vlerën 100,000 lekë; për vitin 2023 në vlerën 370.000 lekë; për vitin 2022 në vlerën 59.800 lekë; për vitet 2021 dhe 2020 në vlerën 0 lekë. 2. dhe 3. Zëri i planifikuar në buxhetin vjetor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është një i vetëm si për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të	
--	--	--	--	---	--

		6. Si llogaritet pagesa që përfiton një përkthyes zyrtar i gjuhës së huaj dhe gjuhës së shenjave për procesin penal dhe me çfarë procedure dhe afatesh kohore realizohet kjo pagesë? 7. Si ka funksionuar përkthimi në procesin penal i personave që nuk dëgjojnë përpara çertifikimit të interpretëve të gjuhës së shenjave nga Ministria e Drejtësisë. 8. A janë gjykatat e të gjitha niveleve përgjegjëse për të paguar përkthyesit e gjuhëve të huaja dhe interpretët zyrtarë të gjuhës së shenjave për shërbimet që ata kryejnë në strukturat e policisë dhe prokurorisë për shtetasit e huaj dhe personat që nuk dëgjojnë? 9. Sa refuzime ka pasur këto 5 vitet e fundit nga përkthyesit zyrtarë të çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë për të marrë pjesë në një proces penal		huaja ashtu dhe për interpretët e gjuhës së shenjave, “Shpenzime përkthimi”, pa i detajuar në mënyrë specifike. Sipas pasqyrës së fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara në zërin “Shpenzime përkthimi”, rezulton se për vitin 2024 buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe për interpretët e gjuhës së shenjave deri më tani është në vlerën 0 lekë; për vitin 2023 është në vlerën 208.574 lekë; për vitin 2022 është në vlerën 54.296 lekë; për vitet 2021 dhe 2020 është në vlerën 0 lekë. 4. Lidhur me këtë pyetje, ju informojmë se e dhëna që kërkohet nga ana juaj, nuk është një e dhënë e cila pasqyrohet në rregjistrat fizikë apo elektronikë të kësaj gjykate, për këtë arsye jemi në pamundësi për t’jua vënë në dispozicion këtë informacion. 5. Në kushtet kur, për zhvillim e një procesi të rregullt ligjor, nevojitet prania e përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave në seancë gjyqësore, kryesuesi i seancës me vendim të ndërmjetëm cakton përkthyesit zyrtar të gjuhës së huaj apo interpretët e gjuhës së shenjave,	
--	--	---	--	--	--

		dhe cilat kanë qenë arsyet e këtyre refuzimeve? 10. Sa raste të mos pagesës së përkthyesve të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave nga gjykatat e të gjitha niveleve ka pasur këto 5 vitet e fundit, për secilin vit dhe pse?		duke i përzgjedhur ato nga lista e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kontaktimi i përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave realizohet me fletëthirrje nga ana e ftuesit të gjykatës. 6. Për përlogaritjen e pagesave për përkthyesit zyrtar të gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave në procesin penal, gjykata zbaton Ligjin Nr.81/2021 <i>“Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”</i> si dhe Udhëzimin e Përbashkët Nr.8, datë 19.07.2022 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë <i>“Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”</i>. Sa i përket procedurave dhe afateve kohore të realizimit të pagesave për përkthyesit zyrtar të gjuhëve të huaja dhe interpretët e gjuhës së shenjave, ju informojmë se nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar këto pagesa kryhen në	
--	--	---	--	--	--

				mënyrë të menjëhershme nga momenti i lindjes së detyrimit. 7. Për përgjigjen e kësaj pyetje ju lutem referohuni në aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë qenë në fuqi përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.81/2021 <i>“Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”</i>. 8. Jo, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përgjegjëse për pagesat e përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave vetëm për shërbimet që ata kryejnë në proceset gjyqësore që zhvillohen në këtë gjykatë. 9. Lidhur me këtë pyetje, ju informojmë se të dhënat që kërkohen nga ana juaj, nuk janë të dhëna të cilat pasqyrohen në regjistrat fizikë apo elektronikë të kësaj gjykate, për këtë arsye jemi në pamundësi për t’jua vënë në dispozicion këtë informacion. 10. Nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ju informojmë se në 5 vitet e fundit nuk ka pasur asnjë rast të mos pagesës së përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së	
--	--	--	--	---	--

				shenjave.		
17.	09.09.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit Nr.18, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	10.09.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 17, datë 09.09.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, po ju vendosim në dispozicion një kopje fizike të vendimit nr.18, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Konfiskimin e pasurive të shtetasve K.B dhe B.B”. Ju sjellim në vëmendje respektimin e dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr.9, datë 15.09.2010 të Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”.	Përfunduar (Dhënë kopje fizike)	Nuk ka
18.	07.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit Nr.6, datë 25.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për	09.10.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 18, datë 07.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.		119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është dhënë vendimi penal nr. 6, datë 25.01.2024, në ngarkim të të pandehurit K.H, i cili është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal. Ky vendim nuk është ankimuar nga palët dhe ka marrë formë të prerë me datë 05.07.2024. Bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin e sipërcituar në rrugë elektronike. Ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2, nenin 11; Udhëzimin Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio	
--	--	---------------------------------------	--	---	--

				vizive”, konkretisht: Kreun I, pika 3, pika 11; Udhëzimin Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
19.	08.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit: 1. Një kopje listën e avokatëve kryesisht të GJKKO-së për vitet-2020- 2024. 2. Nje kopje të dokumentit që vërteton proçeset e përfunduara të secilit avokat kryesisht gjatë periudhës dhjetor 2019 - tetor 2024. 3. Një kopje të listëpagesave të avokatëve kryesisht për çështjet gjatë periudhës dhjetor 2019 deri në 6-mujorin e parë të vitit 2024. 4. Një kopje të dokumentit që, tregon përfaqësimin e	18.10.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 19, datë 08.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Lidhur me pyetjen parë për t’ju vënë në dispozicion një kopje të listës së avokatëve kryesisht të GJKKO-së për vitet 2020-2024, ju informojmë se nuk ka një listë të veçantë për avokatët kryesisht vetëm për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë çdo vit ju dërgon të gjitha gjykatave në Republikën e Shqipërisë listën e azhornuar të avokatëve kryesisht. Sa më sipër bashkëngjitur	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		avokatëve kryesisht për çështjet që kanë përfaqësuar gjatë periudhës dhjetor 2019 deri në tetor 2024.		këtij email-i po ju vëmë në dispozicion të gjitha listat e avokatëve kryesisht për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 që na janë dërguar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë. Lidhur me tre pyetjet e tjera të dërguara nga ana juaj, duke qenë se janë kërkesa shumë të detajuara dhe informacione të tilla mund të gjenden vetëm në dosjet gjyqësore përkatëse, që janë shqyrtuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, që nga viti 2020 deri në vitin 2024, ju sqarojmë se nxjerrja e të gjitha të dhënave që ju kërkoni është një proces objektivisht i pamundur për tu realizuar nga ana jonë, në kuadrin e një kërkesë për informacion. Këto të dhëna nuk ndodhen në një regjistër të vetëm fizik apo elektronik të kësaj gjykate. Nga ana tjetër, ju informojmë se, që nga viti 2022 nga ana e gjykatës janë hedhur në sistemin AFMIS (Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar) të dhëna financiare që i përkasin kësaj gjykate. Nga ky sistem, për t'ju ardhur në ndihmë, kemi arritur të nxjerrim të dhënat e mëposhtme: Për vitin 2022 nga ana e GJKKO-së,		
--	--	--	--	---	--	--

				për shërbimet e ofruara si avokatë kryesisht pranë kësaj gjykate, janë paguar: 1. Avokate ***** në vlerën 18.000 lekë; 2. Avokate ***** në vlerën 18.000 lekë; 3. Avokate ***** në vlerën 9.000 lekë; 4. Avokat ***** në vlerën 6.000 lekë; 5. Avokate ***** në vlerën 138.000 lekë; 6. Avokate ***** në vlerën 30.000 lekë; 7. Avokat ***** në vlerën 9.000 lekë; 8. Avokat ***** në vlerën 25.000 lekë; 9. Avokate ***** në vlerën 6.000 lekë; 10. Avokat ***** në vlerën 25.000 lekë. Për vitin 2023 nga ana e GJKKO-së, për shërbimet e ofruara si avokatë kryesisht pranë kësaj gjykate, janë paguar: 1. Avokat ***** në vlerën 6.000 lekë; 2. Avokate ***** në vlerën 21.000 lekë; 3. Avokate ***** në vlerën 6.000 lekë; 4. Avokat ***** në vlerën 68.000		
--	--	--	--	--	--	--

				lekë; 5. Avokate ***** në vlerën 211.000 lekë; 6. Avokate ***** në vlerën 225.000 lekë; 7. Avokat ***** në vlerën 207.000 lekë; 8. Avokate ***** në vlerën 50.000 lekë; 9. Avokat ***** në vlerën 6.000 lekë; 10. Avokate ***** në vlerën 6.000 lekë; 11. Avokat ***** në vlerën 6.000 lekë; 12. Avokat ***** në vlerën 48.000 lekë; 13. Avokat ***** në vlerën 56.000 lekë; 14. Avokat ***** në vlerën 16.000 lekë; 15. Avokat ***** në vlerën 12.000 lekë. 16. Avokate ***** në vlerën 6.000 lekë; Për vitin 2024 nga ana e GJKKO-së, për shërbimet e ofruara si avokatë kryesisht pranë kësaj gjykate, janë paguar: 1. Avokat ***** në vlerën 147.000 lekë; 2. Avokate ***** në vlerën 266.000		
--	--	--	--	---	--	--

				lekë; 3. Avokate ***** në vlerën 12.000 lekë; 4. Avokat ***** në vlerën 25.000 lekë; 5. Avokat ***** në vlerën 38.000 lekë; 6. Avokate ***** në vlerën 123.000 lekë; 7. Avokat ***** në vlerën 12.000 lekë; 8. Avokate ***** në vlerën 33.000 lekë; 9. Avokat ***** në vlerën 16.000 lekë. VËMENDJE! Në kushtet që, të dhënat e mësipërme janë të dhëna financiare, ngushtësisht personale, ju sjellim në vëmendje respektimin konfidencialitetit të të dhënave, bazuar në: - Dispozitat ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2, nenin 11; Udhëzimin Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio	
--	--	--	--	--	--

				vizive”, konkretisht: Kreun I, pika 3, pika 11; Udhëzimin Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
20.	11.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit të arsyetuar, Nr.36, datë 09.10.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	21.10.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 20, datë 11.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Nga ana e gjyqtarës së çështjes na është komunikuar se, vendimi nr. 36, datë 09.10.2024, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me procedimin pasuror nr. 6 të vitit 2024, lidhur me pasuritë në zotërim të shtetasit O.B dhe familjarëve të tij, procedim ky, i cili ndodhet në fazë hetimi dhe për këtë arsye kopja e arsyetuar e këtij vendimi nuk mund t’ju vendoset në dispozicion. Në këto kushte, po ju vëmë në dispozicion vetëm informacionin	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				lidhur me objektin dhe dispozitivin e vendimit nr. 36, datë 09.10.2024, të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si më poshtë: ... Për sa më sipër, ju sjellim në vëmendje respektimin e: -Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, nenin 2 dhe nenin 11 të tij; -Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, Kreun I, pika 3 dhe 11 të tij; -Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i>, nenin 4, pika 5 të tij.		
21.	11.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të akteve që i përkasin dosjes gjyqësore	23.10.2024	Në zbatim ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, vendimit nr.2312, datë 27.06.2024 të	Përfunduar (Dhënë kopje fizike)	3.345 Lekë

		nr. 69 Vendimi, datë 18.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.		Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimit nr.716, datë 06.12.2023 për <i>“Miratimin e udhëzuesit standard të marrdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”</i> , ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 <i>“Për Arkivat”</i> , i ndryshuar, <i>“Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike në Republikën e Shqipërisë”</i> , Vendimit nr.4, datë 19.6.2017 për miratimin e <i>“Rregullores së Njësuar të Punës me Dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”</i> , kërkesës suaj me nr.213 Prot., datë 24.01.2023, me objekt: <i>“Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”</i> si dhe pas nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit nr.3186/2 prot., datë 23.10.2024, po ju vëmë në dispozicion aktet e kërkuara nga ana juaj që i përkasin dosjes gjyqësore nr.69 Vendimi, datë 18.05.2016, e cila i përket fondit arkivor të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.		
22.	14.10.2024	Kërkesë për informacion: 1. Sa ankime kundër vendimeve të SPAK për mosfillim të hetimeve janë bërë pranë Gjykatës së	24.10.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 22, datë 14.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr.	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		Posaçme, nga viti 2020 deri më tani? 2. Në sa raste Gjykata e Posaçme ka prishur vendimin e mosfillimit duke kërkuar hetime/verifikime të tjera, për të njëjtën periudhë kohore?		119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për vitin 2020 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë shqyrtuar 59 (pesëdhjetë e nëntë) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 7 (shtatë) raste është vendosur shfuqizimi i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimi i Prokurorisë për rregjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për vitin 2021 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë shqyrtuar 53 (pesëdhjetë e tre) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 3 (tre) raste është vendosur shfuqizimi i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimi i Prokurorisë për rregjistrimin e procedimit penal dhe	
--	--	---	--	--	--

				kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për vitin 2022 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë shqyrtuar 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 1 (një) rast është vendosur shfuqizimi i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimi i Prokurorisë për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për vitin 2023 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë shqyrtuar 82 (tetëdhjetë e dy) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 1 (një) rast është vendosur shfuqizimi i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimi i Prokurorisë për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për vitin 2024, deri me datë		
--	--	--	--	---	--	--

				12.07.2024 pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë rregjistruar 31 (tridhjetë e një) kërkesa penale, me objekt “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim të procedimit penal”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Ndër të cilat, në 1 (një) rast është vendosur shfuqizimi pjesërisht i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe urdhërimi i Prokurorisë për rregjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme. Për kërkesat e rregjistruara pas datës 12.07.2024 deri më tani, vendimmarrja e gjykatës mbi këto kërkesa nuk është pasqyruar akoma në sistemin elektronik të gjykatës dhe duke qenë se janë kërkesa që shqyrtohen në dhomë këshillimi, nuk disponojmë informacion lidhur me këtë periudhë.		
23.	22.10.2024	Kërkesë për informacion: Kërkohet informacion nga Gjykata në lidhje me datën e rregjistrimit, datën e shortimit, datën e kalimit në seancë gjyqësore, si dhe datën e seancës së parë gjyqësore, në lidhje	01.11.2024	Në përgjigje të kërkesës për informacion të depozituar nga ana juaj, regjistruar me numër rendor 23, datë 22.10.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë se, refuzojmë kërkesën e	Përfunduar Refuzuar (E-mail)	Nuk ka

		me kërkesat e Prokurorisë për dërgimin për gjykim të procedimeve penale në ngarkim të të pandehurve: L.A, D.A.B, V.D, I.B.		depozituar nga ana juaj për arsyet e mëposhtme: Në nenin 103 të K.Pr.Penale nën titullin “Ndalimi i publikimit të aktit”, në pikën 3 të tij, parashikohet shprehimisht se: <i>“Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë”</i>. Në interpretim të kësaj dispozite, vlerësojmë se, të dhënat e kërkuara në kërkesën për informacion të depozituar nga juaj, lidhur me kërkesat e prokurorisë për dërgimin për gjykim të procedimeve penale në ngarkim të të pandehurve L.A, D.A.B, V.D dhe I.B, në kushtet që, i përkasin dosjeve të seancës paraprake, që zhvillohet me dyer të mbyllura, futen tek të dhënat për të cilat ndalohet publikimi. Në nenin 105 të K.Pr.Penale nën titullin “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve” parashikohet shprehimisht se: <i>“1.</i>	
--	--	---	--	---	--

				<i>Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cildo që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta, apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit”. Në interpretim të kësaj dispozite, vlerësojmë se, me togëfjalëshin “cildo që ka interes” sipas nenit 105 të K.Pr.Penale nënkupton prokurorin, të dyshuarin, personin nën hetim, të pandehurin, kallëzuesin, viktimën ose trashëgimtarët e tij, palët private pra paditësin ose të paditurin në padinë civile në procesin penal. Në këto kushte, çmojmë se, kërkuesi apo ju si përfaqësuese ligjore e tij, nuk përfshihen në rrethin e subjekteve procedurale që legjitimohen për të marrë ekstrakte apo vërtetime të akteve të veçanta nga dosjet për të cilat ju kërkoni informacion. Po ashtu, sipas Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, miratuar me Vendimin Nr. 716, datë 06.12.2023</i>	
--	--	--	--	---	--

				të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në nenin 12 nën titullin “Aksesi në dosjet gjyqësore”, në pikën 1 të tij, parashikohet shprehimisht se: <i>“Dosjet gjyqësore aksesohen në çdo kohë nga palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit”</i>. Përveç parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, vlerësojmë se ky udhëzues, në nenin 12 të tij e përcakton qartë se cilët janë subjektet që mund të kenë akses në dosjet gjyqësore. Në interpretim të nenit mësipërm, vlerësojmë se, kërkuesi apo ju si përfaqësuese ligjore e tij, ashtu siç është arsyetuar dhe më sipër, nuk futeni në rrethin e subjekteve të autorizuar sipas ligjit, për të pasur akses në të dhënat që i përkasin dosjeve për të cilat ju kërkoni informacion. Në këto kushte, për të gjitha arsyet e sipërcituara, refuzojmë kërkesën për informacion të depozituar nga ana juaj.		
24.	31.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimeve të marra nga GJKKO per	06.11.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 24, datë 31.10.2024 në	Përfunduar Pranuar pjesërisht (E-mail)	Nuk ka

		ish-zyrtaret e larte: 1. K.H 2. E.M 3. L.A 4. V.D 5. J.G 6. R.B 7. E.R 8. A.K 9. I.B 10. A.A		regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “ <i>Për të drejtën e informimit</i> ”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se, pranojmë pjesërisht kërkesën tuaj. Më konkretisht, pranojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet e themelit të dhëna për të pandehurit K.H dhe L.A, dhe refuzojmë kërkesën tuaj për pjesën tjetër, për arsyet si më poshtë: Sa i përket kërkesës tuaj lidhur me të pandehurit K.H dhe L.A, ju informojmë se, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë: 1. Vendimi penal nr. 6, datë 25.01.2024, në ngarkim të të pandehurit K.H, i cili është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “ <i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i> ”, parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal. 2. Vendimi penal nr. 85, datë 27.12.2023, në ngarkim të të pandehurve L.A, etj..., i cili është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “ <i>Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike</i> ” parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve të vitit	
--	--	--	--	---	--

				2021) dhe 25 të Kodit Penal, si dhe “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 dhe 25 të Kodit Penal. Bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin nr. 6, datë 25.01.2024 në ngarkim të të pandehurit K.H në rrugë elektronike. Vendimin nr.85, datë 27.12.2023, në ngarkim të të pandehurve L.A, etj., nuk ua dërgojmë dot në rrugë elektronike pasi për shkak të numrit të madh të fletëve (217 fletë) <i>serveri</i> i email-it nuk e lejon të dërgohet. Në këto kushte, mund të paraqiteni personalisht në gjykatë dhe të merrni një kopje të vendimit të hedhur në CD në rast se e dëshironi në këtë format, ose kopje fizike të vendimit. Sa i përket kërkesës tuaj lidhur me shtetasit E.M, V.D, J.G, R.B, E.R, A.K, I.B dhe A.A, ju informojmë se: * Të pandehurit E.M dhe V.D vijojnë të jenë në gjykim themeli pranë kësaj gjykate. Pra, nga ana e gjykatës nuk është dhënë akoma vendim për fajësinë apo pafajësinë e tyre. * Për të pandehurin J.G vijon të shqyrtohet pranë kësaj gjykate kërkesa e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq, pra kjo dosje penale ndodhet akoma në seancë paraprake. * Për shtetasin I.B po shqyrtohen dy	
--	--	--	--	---	--

				dosje penale pranë kësaj gjykate, një dosje penale e cila ndodhet akoma në seancë paraprake, ku shtetasi I.B ka statusin e të pandehurit dhe një dosje penale e cila ndodhet në fazë hetimesh, ku shtetasi I.B ka statusin e personit nën hetim. * Për shtetasin A.A po shqyrtohen dy dosje penale pranë kësaj gjykate, një dosje penale e cila ndodhet akoma në seancë paraprake, ku shtetasi A.A ka statusin e të pandehurit dhe një dosje penale e cila ndodhet në fazë hetimesh, ku shtetasi A.A ka statusin e personit nën hetim. * Për personin nën hetim R.B vijnë të shqyrtohen pranë kësaj gjykate kërkesat që i përkasin fazës së hetimeve paraprake. * Lidhur me shtetasin E.R, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka dërguar për kompetencë kërkesën për <i>“Pushimin e procedimi penal nr. 317, të vitit 2017 të Prokurorisë së Rrethit Kavajë, regjistruar pa autor, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”, pranë Gjykatës së Posaçme të shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka disponuar me</i>	
--	--	--	--	---	--

				vendimin nr. 23, datë 26.03.2024 në seancë paraprake, me dyer të mbyllura. * Për shtetasin A.K, nga verifikimet e bëra në Kryesekretarinë e kësaj gjykate, deri më tani nuk rezulton që ndaj këtij shtetasi të jetë dhënë ndonjë vendim sa i përket kërkesave penale të fazës së hetimeve paraprake, që zhvillohen në seancë gjyqësore, seancë paraprake apo vendim themeli. Për kërkesat penale të fazës së hetimeve paraprake, të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi, nuk disponojmë asnjë informacion, pasi për kërkesa të tilla disponojnë informacion vetëm gjyqtarët e çështjeve dhe prokurorët përkatës. Në këto kushte, në referim të: Nenit 17, pika 2, gërma “b” të ligjit Nr.119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: <i>“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.”</i>; Nenit 103, pika 1, 2 dhe 3 të		
--	--	--	--	---	--	--

				K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: “ 1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv; 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake; 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet e marra nga kjo gjykatë për kërkesat penale që i përkasin fazës së hetimeve paraprake apo seancave paraprake (që zhvillohen me dyer të mbyllura) lidhur me shtetasit E.M, V. D, J.G, R.B, E.R, I.B dhe A.A, pasi siç është cituar dhe më lart, nga ana e gjykatës, për këta shtetas deri më tani nuk është dhënë asnjë vendim themeli.		
--	--	--	--	--	--	--

				Ndërsa për shtetasin A.K, siç është sqaruar dhe më sipër, deri më tani nuk rezulton që ndaj këtij shtetasi të jetë dhënë ndonjë vendim sa i përket kërkesave penale të fazës së hetimeve paraprake, që zhvillohen në seancë gjyqësore, seancë paraprake apo vendim themeli. Vëmendje! Lidhur me vendimet që po ju vihen në dispozicion si dhe informacionet e mësipërme, ju sjellim në vëmendje respektimin e: * Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2, nenin 11; Udhëzimin Nr.9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 3, pika 11; Udhëzimin Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i>, konkretisht:		
--	--	--	--	--	--	--

				Nenin 4, pika 5.		
25.	06.11.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit të arsyetuar, Nr. 112, datë 05.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	18.11.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 25, datë 06.11.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, ju bëjmë me dije se, Vendimi i arsyetuar nr. 112, datë 05.11.2024, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. 102 të vitit 2020”, nuk është zbardhur akoma nga ana e gjykatës.	Në proces	Nuk ka
26.	06.11.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit dhe 1 kopje të vendimit të Shkallës së Parë dhe Apelit, lidhur me rastin e vendimarrjes ndaj të pandehurve G.B, B.H etj...	11.11.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 26, datë 06.11.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë është dhënë vendimi penal nr. 58, datë 03.05.2016, në ngarkim të të pandehurve G.B, G.P, B.H, E.B,	Përfunduar (Marrë CD-ja)	Nuk ka

				V.M, O.R, F.M dhe Z.I. Vendimin e sipërcituar nuk ua dërgojmë dot në rrugë elektronike pasi për shkak të numrit të madh të fletëve (118 faqe) <i>serveri</i> i email-it nuk e lejon të dërgohet. Në këto kushte, mund të paraqiteni personalisht në gjykatë dhe të merrni një kopje të vendimit të hedhur në CD, në rast se e dëshironi në këtë format, ose kopje fizike të vendimit. Në rast se kërkonit të merrni kopje fizike të vendimit nr. 58, datë 03.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ky vendim do ju vihet në dispozicion pasi të bëni pagesën e tarifës përkatëse, në zbatim të Urdhërit Nr.86, datë 17.04.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “<i>Për tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar</i>” (5 lekë për fletë për formatin A4). VËMENDJE! Në kushtet që, po ju vëmë në dispozicion vendimin e mësipërm, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara	
--	--	--	--	--	--

37.	12.12.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit nr. 31, datë 10.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	12.12.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 37, datë 12.12.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, po ju dërgojmë Vendimin Nr. 31, datë 10.05.2023 të Gjykatës së Posaçme	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të ndarë në dy pjesë, në dy email-e pasi për shkak të madhësisë së dokumentit të skanuar, serveri i email-it nuk e ngarkon dot në një email të vetëm. Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor, vendimi i mësipërm ju vihet në dispozicion i paanonimizuar. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2 dhe nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2 dhe 3; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4;	
--	--	--	--	--	--

				- Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
38.	24.12.2024	Kërkesë për informacion: 1. Sa dënime janë dhënë nga Gjykata e Posaçme për akuzën e "Falsifikimit të formularëve dhe stampave" sipas nenit 190 të Kodit Penal nga viti 2020 deri më tani? 2. Cilët janë personat/zyrtarët e dënuar? 3. Sa janë masat e dënimit/dispozitivi për secilin rast?	30.12.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 38, datë 24.12.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për vitin 2024, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë 2 (dy) vendime dënimi për veprën penale “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penale, konkretisht vendimi nr. 6, datë 25.01.2024 dhe vendimi nr. 70, datë 25.11.2024. Për vitin 2023, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është dhënë 1 (një) vendim dënimi për veprën penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penale, konkretisht vendimi nr. 11, datë 02.02.2023. Për vitin 2022, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është dhënë 1 (një) vendim dënimi për veprën penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penale, konkretisht vendimi nr. 34, datë 26.05.2022. Për vitin 2021, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është dhënë 1 (një) vendim dënimi për veprën penale “<i>Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve</i>”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penale, konkretisht vendimi nr. 12, datë 03.02.2021. Për vitin 2020, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e		
--	--	--	--	--	--	--

				Organizuar nuk është dhënë asnjë vendim dënimi për veprën penale <i>“Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”</i>. Lidhur me dy pyetjet e tjera të dërguara nga ana juaj, konkretisht: Cilët janë personat/zyrtarët e dënuar?; Sa janë masat e dënimit/dispozitivi për secilin rast?, po ju vëmë në dispozicion dispozitivët e të gjitha vendimeve të cituara më sipër, të cilat përmbajnë informacionet që ju kërkoni. Për sa më sipër, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, nenin 2 dhe 11 të tij; - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në mediane shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, Kreun I, pika 2, 3 dhe 11; Kreun III, pika 5 të tij;		
--	--	--	--	--	--	--

				- Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”</i> , nenin 4, pika 5.		
39.	27.12.2024	Kërkesë për informacion: Sa vendime fajësie janë shpallur në pesë vjet për veprën e korrupsionit aktiv dhe pasiv, shpërdorimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm Sa vendime pafajësie? Nëse dispononi të dhëna sa çështje për këto vepra janë nën gjykim? Sa pafajësi janë shpallur?	27.12.2024 (Pjesërisht) 06.01.2025 (Përfunduar)	(Datë 27.12.2024) Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 39, datë 27.12.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i> , i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2021 janë dhënë: • 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendime fajësie për veprën penale <i>“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”</i>, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. • 8 (tetë) vendime fajësie për veprën penale <i>“Ushtrimi i ndikimit të</i>	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

				<i>paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. • 2 (dy) vendime fajësie për veprën penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. • 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. • 1 (një) vendim pafajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurororëve dhe funksionarëve të organeve të tjera të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2022 janë dhënë: • 9 (nëntë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit	
--	--	--	--	--	--

				Penal. • 9 (nëntë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. • 3 (tre) vendime fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. • 2 (dy) vendim fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurororëve dhe funksionarëve të organeve të tjera të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. • 2 (dy) vendim fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të organeve të tjera të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal. Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2023 janë dhënë: • 5 (pesë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni aktiv i</i>	
--	--	--	--	--	--

				<i>personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal. • 6 (gjashtë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. • 5 (pesë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Shpërdorimi i detyrës</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. • 13 (trembëdhjetë) vendime fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. • 4 (katër) vendim fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurororëve dhe funksionarëve të organeve të tjera të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. • 1 (një) vendim fajësie për veprën penale “<i>Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose i përkthyesit</i>”, parashikuar nga neni 312 i Kodit Penal.	
--	--	--	--	--	--

				Sa i përket vitit 2024, informacionet e kërkuara do ju përcillen brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 15, pika 1, i ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ku citohet se: <i>“Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.”</i>. (Datë 06.01.2025) Në vijim të përgjigjes së dërguar më datë 27.12.2024, mbi kërkesën tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 39, datë 27.12.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2024, për veprat penale: • <i>“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”</i>,	
--	--	--	--	--	--

				parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, janë dhënë 7 (shtatë) vendime fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie. • “<i>Shpërdorim detyre</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, janë dhënë 9 (nëntë) vendime fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie. • “<i>Korrupsioni aktiv në zgjedhje</i>”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, janë dhënë 5 (pesë) vendime fajësie. • “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, janë dhënë 11 (njëmbëdhjetë) vendime fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie. • “<i>Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, janë dhënë 1 (një) vendim fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie • “<i>Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë</i>”, parashikuar nga neni 319 i K.Penal,	
--	--	--	--	--	--

				janë dhënë 2 (dy) vendime fajësie dhe 1 (një) vendim pafajësie. • “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, janë dhënë 7 (shtatë) vendime fajësie. *Sqarim: Duke qenë se, me të njëjtin vendim një apo disa nga të pandehurit mund të jenë deklaruar të pafajshëm/fajtor për një ose disa nga veprat më sipër, i njëjti vendim është përlllogaritur si vendim fajësie/pafajësie sipas veprave përkatëse. Për vitin 2025: • Për veprën penale “<i>Shpërdorim detyre</i>”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, janë aktualisht në gjykim 5 (pesë) dosje penale. • Për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, janë aktualisht në gjykim 5 (pesë) dosje penale. • Për veprën penale “<i>Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe</i>	
--	--	--	--	---	--

				<i>funkionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, është aktualisht në gjykim 1 (një) dosje penale.</i> • Për veprën penale “<i>Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, është aktualisht në gjykim 1 (një) dosje penale. • Për veprën penale “<i>Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike</i>”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, është aktualisht në gjykim 1 (një) dosje penale.		
40.	30.12.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: 1. Për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar (themeli) për periudhën Tetor - Dhjetor 2024. 2. Vendimet me objekt Sekuestrim/Konfiskim, në zbatim të ligjit nr. 10192,	10.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për dokumentacion të vendimeve të GJKKO-së për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar (themeli), për periudhën Tetor - Dhjetor 2024, si dhe vendimeve me objekt sekuestrim/konfiskim, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 dhe vendimeve me objekt sekuestro preventive/konfiskim në zbatim të K.Pr.Penale, rregjistruar me datë 30.12.2024, me nr. rendor 40 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të ligjit nr.	Përfunduar Pranuar pjesërisht (Marrë CD-ja)	60 lekë

		datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. 3. Vendimet me objekt Sekuestro Preventive/Konfiskim, në zbatim të Kodit të Procedurës Penale.		119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, po ju vëmë në dispozicion një kopje të CD-së që përmban në format elektronik vendimet e cituara si më poshtë: • Vendimi nr. 36, datë 12.06.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimin nr. 38, datë 13.06.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimin nr. 49, datë 31.07.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimi nr. 54, datë 02.10.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimi nr. 55, datë 08.10.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimi nr. 57, datë 15.10.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimi nr. 71, datë 27.11.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin	
--	--	--	--	--	--

				e Organizuar. • Vendimi nr. 74, datë 10.12.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Vendime konfiskimi sipas ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “<i>Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>” për vitin 2024: • Vendimi nr. 1, datë 09.01.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. • Vendimi nr. 5, datë 07.02.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Përveç sa më sipër, ju bëjmë me dije se: • Vendimi nr. 62, datë 21.10.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; • Vendimi nr. 63, datë 25.10.2024 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin		
--	--	--	--	--	--	--

				e Organizuar; • Vendimi nr. 64, datë 28.10.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Linku i faqes së web-it ku gjeni vendimet e sipërcituara: https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/ Në linkun e mësipërm, klikoni në kategorinë “Çështjet gjyqësore”, nënkategorinë “Çështjet penale”. Pasi t’ju shfaqet faqja plotësoni të dhënat përkatëse, në rastin konkret zgjidhni gjyqtarin Erjon Bani, i cili ka dhënë tre vendimet e sipërcituara, vitin 2024, numrin e vendimit dhe klikoni “Kërko”. Në momentin që ju del vendimi përkatës klikoni në tabelën e vogël të emërtuar “Detaje”, tek “Të dhënat” klikoni “Vendimi		
--	--	--	--	---	--	--

				përfundimtar” dhe në fund “Shkarko vendimin”. Ju bëjmë me dije se, në ditët në vijim në faqen zyrtare të gjykatës sonë do të ngarkohen të gjitha vendimet e themelit të shpallura nga kjo gjykatë për vitin 2024, si dhe vendimet që do të shpallen gjatë vitit 2025. Në vazhdimësi, pasi të ngarkohen vendimet e sipërcituara, në faqen zyrtare të gjykatës, në linkun e mësipërm, mjafton të klikoni emrin e gjyqtarit dhe do ju shfaqen të gjitha vendimet e dhëna nga gjyqtari përkatës. Po ashtu, ju informojmë se, pjesa tjetër e vendimeve të themelit për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të shpallura në periudhën e fundit të vitit 2024, akoma nuk janë zbardhur nga ana e gjykatës dhe për këtë arsye jemi në pamundësi për t’ju vënë në dispozicion. Sa i përket kërkesës tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet me objekt: “Sekuestrim në zbatim të ligjit 10 192, datë 03.12.2009 “<i>Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë</i>” për	
--	--	--	--	---	--

				vitin 2024”, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 <i>“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”</i>, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: <i>“1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumentave dhe akteve të paraqitura nga prokurori.”</i>. Pra, sipas dispozitës së sipërcituar kërkesat për sekuestrimin e pasurive janë kërkesa të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi, pa prezencën e palëve. Po ashtu, në nenin 103, pika 1, 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet shprehimisht se: <i>“1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv; 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i</i>		
--	--	--	--	--	--	--

				akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake; 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”. Në nenin 17 pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ... b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.”. Për sa më sipër, duke qenë se, vendimet që kanë për objekt sekuestrimin e pasurive sipas ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të	
--	--	--	--	--	--

				<i>organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, shqyrtohen në dhomë këshillimi dhe i përkasin fazës së hetimit pasuror, në zbatim të nenit 103 të K.Pr.Penale dhe nenit 17, pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, refuzojmë kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion këto vendime.</i> <i>Lidhur me kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet me objekt “Sekuestro Preventive”, parashikuar nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale, ku citohet se: “1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e</i>	
--	--	--	--	---	--

			<i>prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.</i>”, ju bëjmë me dije se, kërkesat për vendosjen e sekuestros preventive, si masa të sigurimit pasuror, janë kërkesa që shqyrtohen në dhomë këshillimi dhe i përkasin fazës së hetimeve paraprake. Për këto arsye, vendimet që kanë për objekt vendosjen e sekuestros preventive, në zbatim të nenit 103 të K.Pr.Penale dhe nenit 17, pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, nuk mund t’ju vendosen në dispozicion. Së fundmi, përsa i përket kërkesës tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimet me objekt “Konfiskim në zbatim të Kodit të Procedurës Penale”, ju informojmë se, kjo pikë e kërkesës tuaj plotësohet me vendosjen në dispozicion të vendimeve të themelit. Në nenin 190 të K.Pr.Penale, nën titullin <i>“Disponimi për provat materiale”</i>, parashikohet shprehimisht se: <i>“1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar: a)</i>	
--	--	--	--	--

				sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, merren dhe i kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale; b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken; c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata. 2. Provat materiale mund t'u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes.”. Në zbatim të dispozitës ligjore të mësipërme, gjykata shprehet në vendimin përfundimtar lidhur me disponimin e provave materiale. Në fund të dispozitivit të vendimeve të themelit që ju janë vënë në dispozicion deri më tani, si dhe vendimeve që po ju vihen në dispozicion sot, gjeni të pasqyruar vendimarrjen e gjykatës lidhur me	
--	--	--	--	--	--

			sendet e sekuestruara. Në zbatim të “Udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” (miratuar me vendimin nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit Lartë Gjyqësor), vendimet e mësipërme ju vihen në dispozicion të paanonimizuara. Në këto kushte, ju sjellim në vëmendje respektimin e: - Dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar, konkretisht: Nenin 2, nenin 11. - Udhëzimit Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”</i>, konkretisht: Kreun I, pika 2 dhe 3; Kreun III, pika 5 dhe 6; Kreun IV, pika 4. - Udhëzimit Nr. 31, datë 27.12.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale <i>“Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie,</i>		
--	--	--	--	--	--

				<i>letrare ose artistike</i> ”, konkretisht: Nenin 4, pika 5.		
--	--	--	--	--	--	--